



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-11729/26
Kaçanik, 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12, 17 shkronja (o) lidhur me nenin 40.2 shkronja (i) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 29/ 27 Dhjetor 2011), të nenit 6.1 dhe 6.2 shkronja (o) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 maj 2026, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut si dhe Emërtimin e Objekteve Komunale

1. Me këtë Vendim, EMËROHET Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut si dhe Emërtimin e Objekteve Komunale, me këtë përbërje:
 - 1.1 Visar Mulaku, anëtar (Ekzekutivi)- Zyrtar në DUKMM
 - 1.2 Ardita Shehu-Raka anëtare (Ekzekutivi)- Zyrtare në DUKMM
 - 1.3 Xhelal Ceka anëtar i Kuvendit nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK
 - 1.4 Enis Vishi anëtar i Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje-LVV
 - 1.5 Burim Bunjaku anëtar nga Shoqëria civile/ OJQ të dala nga lufta e UÇK.
2. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tij.
3. Detyrë e Komisionit nga pika një (1) e këtij vendimi është që të bëjë organizimin, grumbullimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave në territorin e Komunës së Kaçanikut dhe Emërtimin e Objekteve Komunale.
4. Komisioni për punën e vetë raporton para Kuvendit të Komunës.
5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të hartoj dhe miratoj kriteret e brendshme për punën e vet dhe të bashkëpunojë ngushtë edhe me ish Komisionin.

6. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës, përveç nëse merret ndonjë vendim tjetër.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
8. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: MAPL, Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njësia Org. Org. Jevetiza Org. Unit DL
Nr. i Stages Broj stranica No. pages 02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. 3088-2/26
Data Datum Date 10.06.26
PRISTINE/A

I	Data 16.06.2026	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-14478-1.	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 111/26 MMPH Date: 08.06.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim 01Nr.104/02-11729/26 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut si dhe emërtimin e objekteve komunale

I nderuar kryetar Vishi,
I nderuar kryesues Troni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 04.06.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01Nr.104/02-11729/26 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut si dhe emërtimin e objekteve komunale

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave nuk është e rregulluar procedura për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike. Ky akt lidhet me formimin e komisioneve të brendshme të organeve komunale, që janë të përcaktuara në legjislacion tjetër përkatës në fuqi.

Prandaj, MMPH vlerëson se nuk është kompetente për të dhënë vlerësim të ligjshmërisë lidhur me këtë vendim.

